



32

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E HETIMIT

Rr. " Qemal Stafa ".... Tel/fax + 355 4 258053

Nr. 872/1 Prot

Tiranë, me dt. 03.04.2003

L E N D A : Për fiksimin, përpunimin, administrimin dhe trajtimin e gjurmëve të gishtave të gjetura në vendin e ngjarjes.

PROKURORIVE TE RRETHEVE

Në praktikën e punës, jo në pak raste prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe specialistët e të kriminalistikës, janë të pranishëm e operojnë në vendngjarje me pasoja kriminale, për të fiksuar, përpunuar, administruar e trajtuar gjurmë, sende e objekte të lëna ose të përdorura nga autori ose autorët e krimit, të cilat marrin cilësinë e provës e shërbejnë edhe për të identifikuar pjesëmarrësit në krim.

Në këtë kuadër, rëndësi të dorës së parë merr kujdesi që duhet treguar në këqyrjen e vendit të ngjarjes, për gjetjen fiksimit, administrimin e trajtimin e gjurmëve, objekteve dhe sendeve të gjetura në këtë vend, për më tepër kur dihet që është një veprim i papërsëritshëm dhe i pazëvendësueshëm.

Në sferën e gjurmëve të gjetura në vendin e ngjarjes, përfshihen edhe gjurmët e gishtave, që dihet që janë si pasaportë nga personi që i ka lënë ato e për këtë shkak për fiksimin, trajtimin administrimin e përpunimin e tyre duhet të tregohet një kujdes edhe më i madh. I mëshojmë këtij fakti se nuk tregohet kujdesi i duhur për vlerësimin e këtij problemi e bile në ndonjë rast, për shkak të pakujdesisë apo dhe të paaftësisë, këto gjurmë humbasin edhe vlerën e provës, pavarësisht se thuhet që janë marrë në vendin e ngjarjes.

Ilustrimet për rastet nuk mungojnë, e më pikanti është ai i ngjarjes së ndodhur në qytetin e Durrësit në datën 01.10.2002, kur në vendin e ngjarjes pretendohet se është fiksuar edhe një gjurmë gishti më vlera identifikuese, e më vonë pretendohet se për vlerësimin e saj është trajtuar një gjurmë tjetër gishti dhe jo ajo e gjetur dhe e dërguar për tu vlerësuar nga vendi i ngjarjes.

Për këtë rast përgjegjësia ngeli e shpërndarë për shkaqe të ndryshme e kryesisht subjektive, të cilat nuk duhet të përsëriten në të ardhmen. E që të mos përsëriten ato duhet të kihet parasysh që:

Përpunimi i gjurmëve të gishtave në vendin e ngjarjes duhet të behet mjaft i kujdesshëm, që në asnjë rast ato të mos humbasin vlerat identifikuese. Karakteristikat e këtyre gjurmëve duhet të përshkruhen në proces verbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes ashtu siç shihen me sy të lirë duke nxjerrë në pah tipin e tyre që, mund të jenë rrethore, lakore etj e një gjë e tillë të realizohet pasi më parë të jetë përshkruar me hollësi vendi se ku gjendet gjurma.

Gjurma e gishtit e gjetur në vendin e ngjarjes kur nuk ka vështirësi për fotografimin e saj duhet fotografuar në vend e në rast të kundërt realizohet marrja e saj me gjurmëkopjues e jo në çdo rast të përdoret gjurmëkopjuesi, si mjete më i lehtë për fiksimin e gjurmës. Për më tepër, kur gjurma është marrë me gjurme kopjues më shumë se një herë, një gjë e tillë duhet të shënohet në proces verbalin e këqyrjes se vendit të ngjarjes.

Në rastin kur gjurma e gishtit është marrë me gjurmëkopjues shënimet për të në gjurmëkopjues duhen bërë jo vetëm për ngjarjen por edhe për karakteristikat e gjurmës, që shihen me sy të lirë.

Në rastet kur gjurma e fiksuar në vendin e ngjarjes duhet dërguar për tu vlerësuar në një laborator tjetër, vendimi për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik nuk duhet bërë formalisht. Në këtë vendim duhet të pasqyrohen, vendi ku është marrë gjurma, mënyra e fiksimit të saj, karakteristikat e saj, numri i tyre e së fundi se çfarë kërkohet për tu vlerësuar.

Duke patur parasysh problemet e trajtuara më sipër, nuk do ti lihet shteg keqinterpretimeve apo shmangies nga përgjegjësia.

Ky material të punohet me prokuroret dhe oficerët e policisë gjyqësore pranë këtyre prokurorive.

**PROKURORI I PËRGJITHSHEM
THEODHORI SOLLAKU**



